



ELINA DUNI

foto nga
Elerta Kambo
Nicolas Masson

Ky numër i Albania, ishte planifikuar të publikohej pa intervista, pra vetëm me shkrime dhe lajme artistike, por kur Elina i tha po, kërkesës sonë për intervistë...ne nuk kishim si mos ti ndërronim planet menjëherë. Të njohur me muzikën e saj prej disa vitesh, Elina është bërë pjesë e preferuar e koleksionit tonë muzikor dhe një prej emrave më të rëndësishëm të muzikës shqiptare në dekadën e fundit. Me nëntë albume dhe kontratë me "ECM Records" (Pjesë e "Universal Music Group") ajo ka ndërtuar një karrierë si një prej emrave më të mirë të xhazit momentalisht në Europë e botë. Përtej krijimtarisë muzikore dhe faktit që është një ndër të rrallat kantautore në Shqipëri, Elina është dhe një prej ambasadoreve më të mira të muzikës shqiptare. Albumi i ri "Dallëndyshe" (po si edhe të mëparshmit) vazhdon të vërtetojë më së miri këtë rol të saj, duke qënë dukshëm i influencuar nga muzika folkloristike shqiptare, e sjellë në të sotmen me elegancën dhe pëkuqjesjen e duhur.



Përsëritet Elina! Ku jeni në këto momente dhe me çfarë jeni duke u marrë?

Jam momentalisht në Bern, në Zvicër ku jetoj. Sapo mbajta një koncert solo në një festival të madh të xhazit, po përgatis daljen e albumit të ri "Dallëndyshe", me kuartetin ashti si dhe dhe koncertet në vijim.

Çfarë mund të na tregoni rreth këtij albumi?

Albumi është i katërti i Elina Duni Quartet, dhe i dyti tek shtëpia diskografike shumë e njohur e xhazit "ECM". Sjell këngë të vjetra shqiptare të gërshtuara me xhazin. Atëherë, nëse "Matanë Malit" kishte diçka më tragjike, "Dallëndyshe" më duket më i hareshëm, më ritmik dhe pse tematika e tij është mërgimi dhe dashuria.

Ndërkohë që në Shqipëri, artistët duken si të friguar nga gjithçka shqipe, mua më pëlqen se sa "shqipëtare" jeni në krijimet tuaja. Ritmet, tekstet, titujt e këngëve... çdo gjë i ka rrënjët në të qenit shqiptarë dhe çdo krijim e keni sjellë në mënyrë fantastike tek publiku. A nuk është për të ardhur keq që ne si popull kemi një kulturë kaq, kaq të pasur, por shumë pak të shfrytëzuar?

Unë kam 11 vjet që punoj me këngët e vjetra shqipe, të cilat kanë qënë për mua dhe vazhdojnë të jenë një shkollë e vyer. Më kanë mësuar shumë mbi poezinë, melodinë, ritmin dhe mënyrën se si ta punoj zërin tim. Gjithashtu më kanë frymëzuar disi për krijimet e mia tek albumi "Muza e Zezë".

Ne kemi vërtet një kulturë shumë të pasur, por komunizmi nga një anë - i cili e ka përdorur atë si armë propagande - dhe tranzicioni - që gjithë këto vjet e ka lënë pas dore mirëmbajtjen e trashëgimisë kulturore - kanë dhënë si rezultat një distancë midis kulturës dhe publikut.

Për të jua bërë pak më të qartë atë çka doja të thoja më sipër, ndërkohë që ju publikoni "Sytë" këto janë disa prej titujve të këngëve më të reja në treg : "Save Me", "High3", "I'm Alive", "A je gati", "S'je My Lifestyle", "Fly Up", "Shume qel" etj. A nuk është qesharake? Të duket sikur gjuha e dytë në Shqipëri është anglishtja.



Ky është një fenomen mbarëbotëror fatkeqësisht. Jetojmë në diktatin e mediave dhe të komercializmit dhe disi të imperializmit së gjuhës angleze. Është shumë e vështirë t'i shpëtojmë dhe është për të ardhur keq se artistët që këndojnë tekstet më të bukura në anglisht nuk janë ata që dëgjojnë më së shumti sigurisht.

Dallëndyshja tek në është simboli dhe paralajmëruesja e ardhjes së pranverës, apo e kohërave më të mira... në çfarë simboli paraqitet këtu në albumin tuaj?

Kënga e fundit e albumit quhet "Dallëndyshe" dhe është një këngë arbëreshe e cila flet për ikjen në Itali në të cilën i këndohet dallëndyshe: /Dallëndyshe e lerë e lerë/ kur të vish ti njatër herë/ vjen të vish ti te Korona/ më nën gjen ti shpiti tona/. Pra është simboli i mërgimit në këtë rast.

Të kujt janë "Sytë" të cilëve ju këndon?

Kënga "Sytë" është shkruajtur nga Isak Muçolli në vitet 60 dhe e kënduar nga e madhja Nexhmije Pagarusha. Titulli i vërtetë është "Sytë për ty i kam të njome".

Po nëse dikush do t'u këndonte syve tuaj, si e imagjinoni do tingëllonte kënga? Po vargjet?

Nuk dua ta imagjinoj, preferoj ta kem surprizë. Një nga poezitë e para që kam shkruajtur në moshën 8-9 vjeç quhej "Sytë e tu" dhe i kushtojë mamasë sime Besa Myftiu, që vërtet ka sy të jashtëzakonshëm.

Sytë e tu janë si liqenet që prarohen nga rrezet e diellit
Sytë e tu janë si deti i zënë në pranga nga shtetet
Sytë e tu janë si lumenjtë që s'pushojnë së rrjedhuri
Sytë e tu janë si malet në mjegull
Sytë e tu të ngjallin çdo ndjenjë

Përse e zgjodhët ("Sytë") si këngën prezantuese të këtij albumi ? Zakonisht kënga e parë që prezantohet nga një album është një farë paralajmërimi si të thuash se çfarë pritet muzikalisht apo shpirtërisht nga ky album ose kënga më e preferuar e artistit nga ky album. Po në rastin tuaj?

Është një këngë shumë sensuale që flet për dashurinë dhe natën nga pikëpamja e një femre, një gjë që për atë kohë dhe për atë stil muzikor është mjaft e rrallë. Kënga ka edhe një ritëm, një lloj "ostinato" të luajtur nga pianoja që të fut në një lloj gjëndje transi. Melodia është e afërt dhe e largët njëkohësisht, si një mirazh në shkretëtirë. Është një këngë e cila nuk i përket më asnjë kohe, duket sikur është pjesë e të gjithëve dhe kjo është ajo që unë dua të pasqyroj në këtë album: Një muzikë që i përket të gjithëve, publikut shqiptar por dhe publikut të huaj, muzika gjuha universale, sigurisht! Jam shumë e lumtur gjithashtu me realizimin e videos nga Kleidi Eski, i cili ka bërë një punë të shkëlqyer. Videoja e animuar i jep këngës një thellësi të veçantë dhe sugjeron shumë interpretime të ndryshme.

A mund të na bëni një prezantim të shkurtër të pjestarëve të kuartetit tuaj?

Kuarteti ekziston që prej vitit 2005 dhe kam fatin të punoj me muzikantë të mrekullueshëm:

Colin Vallon në piano, një nga pianistët më interesantë në Evropë, gjithashtu i publikuar të "ECM" me trion e tij. Lukas Traxel në kontrabas, i ri në grup, vetëm 21 vjeç dhe një nga basistët më të kërkuar tashmë. Norbert Pfammatter në bateri, një mjeshtër i ritmit dhe i ritmikës komplekse të Ballkanit.

Sa këngë do të ketë albumi dhe kur do të dalë në shitje?

Albumi ka 12 këngë dhe sapo ka dalë në treg në Evropë kurse në Shqipëri, Kosovë e Maqedoni do të dalë gjatë turneut që është planifikuar në shtator.

Po në Amerikë a do të jetë në shitje nëpërmjet iTunes apo dyqaneve të tjera online?

Po, sigurisht do të jetë në iTunes edhe në Amerikë, ndërsa disku do të vibet në shitje nëpërmjet dyqane nga shpërndarësi "Universal".

Interpretimet tuaja live janë fantastike. Koncerti që ju mbajtët në Tiranë, është cilësuar si ndër më të mirët e këtyre 15 viteve të fundit. Si ja bëni që të jeni kaq në formë- profesionalisht, pavarësisht se vazhdimisht jeni në turne e në udhëtime?

Më vjen shumë mirë që koncertet e mia vlerësohen kaq shumë. Muzika që bëj e merr kuptimin e plotë live në fakt. Magjia e xhazit është pikërisht momenti, improvizimi, ajo çfarë luhet së bashku. Për mua është momenti më i bukur i jetës së një muzikanti, pikërisht ajo që ndajmë me publikun dhe që marrim prej tij. Aty çdo sakrificë, çdo lodhje harrohet.

Interpretimi juaj tek TEDx Place Des Nations!!! Ishte fantastik! Ku mund ta gjej versionin tuaj të "Moj e bukura More"?

Faleminderit! Kënga gjëndet në You Tube.

E përse i përket turneut, në cilat qytete do mbani koncerte për promovimin e "Dallëndyshe"? Po në Amerikë a keni ndonjë plan?

Do jemi nëpër Evropë dhe datat e koncerteve janë tek faqja www.elinaduni.com Për Amerikën s'ka akoma plan. Në tetor të vitit 2012 gjatë promovimit të diskut "Matanë Malit" kemi bërë një turne dhe shpresoj që do kemi mundësi ta çojmë edhe "Dallëndyshe" atje.

Vitin që shkoj ju kemi parë bashkë me Eda Zarin dhe Dren Abazin. A jeni duke punuar për ndonjë projekt tjetër së bashku? Që të tre më pëlqeni shumë.

Projekti ka qënë "1001 Endrra Dimri" i realizuar nga "Digitalb" dhe ka qënë një eksperiencë e bukur. Për momentin, secili nga ne është i angazhuar me projektet personale dhe nuk ka plan për diçka të re së bashku.

Kritiku i njohur i xhazit si dhe kritiku kryesor i "The Guardian", britaniku John Fordham ju ka cilësuar si një "yjl në rritje". Si ndiheni kur lexoni vlerësime të tilla të rangut ndërkombëtar? Po publiku i huaj si reagon kur dëgjon xhaz shqiptar?

Për mua e rëndësishmja në muzikë është të marrësh me vete publikun në një udhëtim. Ky udhëtim mund të jetë në çfarëdo lloj gjuhe, sepse është ajo ç'ka transmeton, ç'ka jep që është parësore. Tematikat e folkut shqiptar si dashuria, mërgimi, liria janë universale dhe është pikërisht kjo që prek publikun, është ky mesazh gjithëpërfshirës i cili na bashkon qofshim shqiptarë a të huaj.

Keni një kontratë me "ECM Records" në Gjermani, pjesë e "Universal Music Group" dhe shtëpi diskografike mitike e xhazit. Njiheni dhe vlerësoheni në skenën ndërkombëtare të xhazitit. Në repertorin tuaj me kuartetin keni katër albume tashmë "Dallëndyshe" (2015), "Matanë malit" (2012), "Lume Lume" (2010) dhe "Baresha" (2008) dhe si kantautore "Muza e Zezë" (2014). Cilat janë synimet për vitet e ardhshme?

Dua të vazhdoj të kompozoj këngët e mia këtë herë në frengjisht dhe anglisht, të shkruaj një skenar filmi dhe të udhëtoj. Por dua të them që jam shumë e lumtur dhe i jam mirënjohëse jetës për gjithëçka që më ka dhënë deri tani.

Intervistoi/Përgatiti: Elbino Albanac 03/2015

